

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE SHKODER



Nr.Rep. 3548  
Nr.Kol. 1559

### KONTRATE SHITBLERJE TE KUOTAVE TE SHOQERISE

#### “ ERIKU “ SH.P.K.

Ne Shkoder sot me daten **06.12.2019**, perpara meje notere **Bardhe Brushtulli** me seli ne Shkoder rruga “ Don Bosko “, u paraqiten personalisht palet :

**SHITESI: KOL ZEFAJ**, i biri i Jak, i datelindjes 10.11.1962, lindur ne Shkoder dhe banues ne Vau Dejes, me nr. Personal G21110027S.

Dhenesi i Pelqimit bashkeshortja Znj.Kristina Zefaj, e datelindjes 01.03.1964, lindur ne Shkoder dhe banuese ne Vau Dejes, me nr. Personal G45301065B.

**BLERESI : VALBONA BABAJ**, e bija e Ndue, e datelindjes 28.08.1977, lindur ne Laç, Shkoder dhe me banim ne Mjede-Vau Dejes, me nr. Personal H75828208L.

per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te dokumentit identifikues perkates qe ata mbanin , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se :

Une shitesi Kol Zefaj jam ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**ERIKU**” **SH.P.K.** me 100 % te kuotave te barabarte me **100.000** leke, e njohur kjo shoqeri si person juridik dhe e regjistruar ne QKB me nr.NIPTI L76626004D, me administrator te shoqerise Z. Kol Zefaj.

Une shitesi i siperpermendur Kol Zefaj , i shes bleresit Znj. Valbona Babaj , **50 % te kapitalit (kuotave) te barabarte me 50.000 leke.**

Bleresi Valbona Babaj eshte dakort per blerjen e 50 % te kapitalit themelor te barabarte me **50.000** leke te shoqerise «**ERIKU**» Sh.P.K. dhe merr persiper detyrimet dhe te drejtat qe lindin nga kjo kontrate shitblerje kuotash, duke u bere ortak i kesaj shoqerie me 50 % te kapitalit themelor me vlere 100.000 leke.

Perfundimisht shoqeria “ **ERIKU**” SH.P.K. do te kete ortak te Shoqerise Znj. Valbona Babaj me **50 %** te kapitalit themelor me vlere 100.000 leke.

Administrator i shoqerise «**ERIKU**» Sh.P.K. do te jete Z. Kol Zefaj per nje afat prej 5 vjet kohe.

Kjo kontrate u hartua ne baze te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, Kodi i Civil i Republikes se Shqiperise etj.

Kjo kontrate shitblerje kuotash pasi u lexua me ze te larte para paleve dhe u gjet konform vullnetit tyre te plote duke u neshkruar si me poshte rezulton , çka e vertetoj une si noter sipas ligjit.

SHITESI

BLERESI

NOTERE Bardhe Brushtulli

*Kol Zefaj*

*Valbona Babaj*

*Kristina Zefaj*

*Valbona Babaj*